REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE, PROSTORNONG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: DL
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 1121-2/23
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No.Pages: -02-
Data / Datum / Date: 15.03.23
PRISHTINË / A
No. 1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës<br>Bexhet Kuqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës | |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL<br>Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër i MMPHI<br>Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI | |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor | Nr.VL-57/23<br>Datë:13.03.2023 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal | |
| Lloji i aktit: | Vendimi Nr.016-14454 për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë. | |

I nderuari Kryetar, Muharremaj,
I nderuari Kryesues, Kuqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimi Nr.016-14454 për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë, datë 28.02.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Suharekës, konstaton :

**Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit**

Vendimi Nr.016-14454 për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë, datë 28.02.2023.

**A r s y e t i m i**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.016-14454 për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë, konstatoi se:

- **Neni 1** i vendimit Nr.016-14454 për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Shirokë, të plotësohet me të dhënat e Zonave Kadastrale dhe parcelat kadastrale që përfshihen në këtë plan.

**Vërejtje:**
Lidhur me sipërfaqet e parapara për hartimin e këtij plani, sipërfaqet janë të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës në fuqi dhe si të tilla duhet të respektohen.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.